

UDHËZIM
Nr.647/1, datë 15.5.2006

MBI DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.647, DATË 20.03.2006 “MBI ZBATIMIN E VENDIMIT TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NR. 632, DATË 11.02.1999 “PËR PROGRAMIN E NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESEVE TË PAPUNA FEMRA””

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, në zbatim të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papuna femra” dhe të nenit 18/1 të Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit, miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.42, datë 17.01.1998 “Për miratimin e Statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, i ndryshuar”, Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.647, datë 20.03.2006 “Mbi zbatimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.632, datë 11.02.1999 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkuesve të papuna femra”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 2 riformulohet si vijon:

“Punëdhënësit që aplikojnë duhet të plotësojnë këto kushte:

i) nuk duhet të kenë bërë pushime nga puna (pa shkaqe të arsyeshme) për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

ii) të kenë derdhur rregullisht sigurimet e detyrueshme për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare;

iii) të mos kenë pasur shkelje të legjislacionit të punës të verifikuara nga Inspektorati i Punës për aq kohë sa kryejnë aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.

2. Në pikën 3 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në paragrafin “e” shprehja në kllapa “(për të paktën 1 vit)” zëvendësohet me shprehjen “(për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare)”

Pika “i” riformulohet si vijon:

“i) Vërtetim nga dega e tatim-taksave ku ushtron veprimtarinë personi juridik/fizik, për shlyerjen e detyrimeve tatimore, për aq kohë sa kryen aktivitetin, por jo më gjatë se një periudhë njëvjeçare.”

3. Në fjalinë e dytë të pikës 4 shprehja “... 418 datë 25.02.2004 të ...”, zëvendësohet me lidhëzën “e”.

4. Në pikën 5 fjalia e dytë riformulohet si vijon:

“Zyra kompetente e punësimit ia paraqet projektet Këshillit Lokal Tripalësh, i cili i shqyrton dhe vendos mbi dobishmërinë social-ekonomike të projekteve që do të kërkohen të financohen.”

5. Pika 8 riformulohet si vijon:

“Mënyra e vlerësimit të projekteve përcaktohet në rregulloret e komisioneve.

6. Në pikën 22 fjalia e fundit ndryshohet si vijon:

“Zyra e punësimit merr masa për zëvendësimin e punëmarrësve të larguar.”

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA
Koço Barka**